Numër: 01/39
Datë: 22.02.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 22.02.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "International Business College Mitrovica", me adresë: Rr. Bislim Bajgora p.n., Mitrovice, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 22.02.2022 deri më 21.02.2025, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

1.1. **Asistent Administrativ,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 14 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetepesë (25) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen tre (3) grupe.

1.2. **IT Help Desk,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim i Bazuar në Standarde Ndërkombëtare (E) me 8 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzet (20) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen tetë (8) grupe.

1.3. **Menaxher i Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 7 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzet (20) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen tre (3) grupe.

1.4. **Shitje dhe Shërbimi i Klientit,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 13 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzet (20) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen tre (3) grupe.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit "International Business College Mitrovica", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "International Business College Mitrovica", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK